LIGJ
Nr.10 094, datë 12.3.2009

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË DUKATIT TË MADH TË LUKSEMBURGUT PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL, PËR TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6121, datë 2.4.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË DUKATIT TË MADH TË LUKSEMBURGUT PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut,

me dëshirën për të lidhur një marrëveshje për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Personat e përfshirë

Kjo marrëveshje do të zbatohet për personat të cilët janë rezidentë të një ose të dy shteteve kontraktuese.

Neni 2
Tatimet e përfshira

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin, të vendosura

në emër të një shteti kontraktues ose të autoriteteve të tij lokale, pavarësisht nga mënyra në të cilën ato janë vënë.

2. Do të konsiderohen tatim mbi të ardhurat dhe kapitalin të gjitha tatimet e vëna mbi të ardhurat totale, kapitalin e përgjithshëm ose elemente të të ardhurave apo kapitalit, duke përfshirë tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pronës së luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi shumat totale të pagave ose rrogave të paguara nga ndërmarrjet, si dhe tatimet mbi vlerësimin e kapitalit.

3. Taksat ekzistuese për të cilat zbatohet Marrëveshja, në veçanti janë:

a) në rastin e Republikës së Shqipërisë:

i) tatimi mbi të ardhurat (duke përfshirë tatimet mbi përfitimet e korporatës dhe tatimi mbi të ardhurat individuale);

ii) taksa mbi aktivitetet e biznesit të vogël; dhe

iii) tatimin e pronësisë.

(në vijim referuar si "tatimi shqiptar").

b) në rastin e dukatit të Madh të Luksemburgut:

i) taksa mbi të ardhurat për individët (l'impôt sur le revenu des personnes physiques);

ii) taksa e korporatës (l'impôt sur le revenu des collectivites);

iii) taksa mbi kapitalin (l'impôt sur la fortune); dhe

iv) taksa kominale e tregtisë (l'impôt commercial communal);

(në vijim të referuara si "tatimi i Luksemburgut"),

4. Marrëveshja zbatohet gjithashtu për çdo taksë të njëjtë ose në thelb të ngjashme që është vendosur pas datës së nënshkrimit të marrëveshjes, si shtesë ose në vend të taksave ekzistuese. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën në lidhje me çdo ndryshim thelbësor që është bërë në ligjet e tyre përkatëse mbi tatimet.

Neni 3

Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe:

a) Termi "Luksemburg" nënkupton Dukatin e Madh të Luksemburgut dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Dukatit të Madh të Luksemburgut;

b) Termi "Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si dhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila sipas ligjeve të saj dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin e detit, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

c) Termi "person" nënkupton një individ, firmë dhe çdo grup tjetër personash;

d) Termi "firmë" nënkupton çdo person juridik ose çdo ent që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

e) Termi "ndërmarrje e një shteti kontraktues" dhe "ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues" nënkuptojnë përkatësisht një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i një shteti kontraktues dhe një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i shtetit tjetër kontraktues;

f) Termi "trafik ndërkombëtar" nënkupton çdo transport me anije ose avion të vënë në punë nga një ndërmarrje që e ka vendin e saj të menaxhimit efektiv në një shtet kontraktues, përveçse kur anija ose avioni vihen në punë vetëm midis vendeve në shtetin tjetër kontraktues;

g) Termi "autoritet kompetent" nënkupton:

i) në rastin e Luksemburgut, Ministrinë e Financave ose përfaqësuesin e saj të autorizuar;

ii) në rastin e Shqipërisë, Ministrinë e Financave ose përfaqësuesin e saj të autorizuar;

h) Termi "shtetas" nënkupton:

i) çdo individ që ka kombësinë e një Shteti Kontraktues;

ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqëri, statusi i të cilave rrjedh nga ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues.

2. Për sa i përket zbatimit të Marrëveshjes në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term i papërkufizuar në të, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ka pasur në atë kohë sipas ligjit të atij shteti për qëllime tatimore për të cilat zbatohet kjo Marrëveshje, çdo kuptim sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij shteti që ka përparësi mbi një kuptim të dhënë termit sipas ligjeve të tjera të atij shteti.

Neni 4
Rezidenti

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi "rezident i një Shteti Kontraktues" nënkupton çdo person i cili sipas ligjeve të atij shteti, është përgjegjës për tatimet përkatëse për shkak të banesës së tij, rezidencës, vendit të menaxhimit, vendit të regjistrimit ose çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe gjithashtu përfshin atë shtet ose çdo autoritet lokal të tij. Megjithatë, ky term nuk përfshin personat që janë përgjegjës për tatimet në atë shtet, në lidhje vetëm me të ardhurat nga burimet në atë shtet ose kapitalin e vendosur në të.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, statusi i tij përcaktohet si më poshtë:

a) ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ka banesën e përhershme në dispozicion; nëse ka banesën e përhershme në dispozicion në të dyja shtetet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit me të cilin ka marrëdhënie më të afërta personale dhe ekonomike (qendra e interesave jetësorë);

b) nëse shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetësorë nuk mund të përcaktohet ose nëse nuk ka banesë të përhershme në dispozicion në secilin shtet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ka banesë të përhershme;

c) nëse ka vendbanim fiks në të dyja shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit nga i cili është shtetas;

d) nëse është shtetas i të dyja shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese e zgjidhin çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person i ndryshëm nga një individ, është rezident i të dyja Shteteve Kontraktuese, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit të tij efektiv.

Neni 5
Vendqëndrimi i përhershëm

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi "vendqëndrim i përhershëm" nënkupton një vend fiks biznesi nëpërmjet të cilit zhvillohet biznesi i një ndërmarrjeje në mënyrë të plotë ose të pjesshme.

2. Termi "vendqëndrim i përhershëm" përfshin në veçanti:

a) një vend menaxhimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte, dhe

f) një minierë, një pus nafte ose gazi, një gurore ose një vend tjetër të nxjerrjes së

burimeve natyrore.

3. Termi “vendqëndrim i përhershëm” gjithashtu përfshin:

a) një shesh ndërtimi, një projekt ndërtimi, montimi ose instalimi apo aktivitetet mbikëqyrëse lidhur me të, por vetëm kur ky shesh, projekt ose aktivitet vazhdon për një periudhë prej më shumë se dymbëdhjetë muaj, dhe

b) dhënien e shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e konsulencës, nga një ndërmarrje nëpërmjet punonjësve ose personelit tjetër të angazhuar nga ndërmarrja për këtë qëllim, por vetëm kur aktivitetet e asaj natyre vazhdojnë brenda vendit për një periudhë prej më shumë se dymbëdhjetë muaj.

4. Pavarësisht nga dispozitat pararendëse të këtij termi “vendqëndrim i përhershëm” konsiderohet të mos përfshijë:

a) përdorimin e mjediseve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje të mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje;

c) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim të përpunimit nga ndërmarrja tjetër;

d) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të blerjes së mallrave ose të mbledhjes së informacionit për ndërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të vazhdimit nga ana e ndërmarrjes, të çdo aktiviteti tjetër të karakterit përgatitor ose ndihmës;

f) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët (a) deri (e), me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit fiks të biznesit që rezulton nga ky kombinim të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 6, vepron në emër të një ndërmarrjeje dhe ka, si dhe ushtron rregullisht, në një Shtet Kontraktues autoritet për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes, ajo ndërmarrje do të konsiderohet të ketë vendqëndrim të përhershëm në atë shtet në lidhje me çdo aktivitetet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, për sa kohë që aktivitetet e atij personi janë të kufizuara ndaj atyre të përmendura në paragrafin 4 të cilat, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk do ta bënin këtë të fundit vendqëndrim të përhershëm sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një ndërmarrje nuk do të konsiderohet të ketë vendqëndrim të përhershëm në një Shtet Kontraktues vetëm ngaqë zhvillon biznesin në atë shtet nëpërmjet një agjenti, komisioneri tregtar të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që ata persona të veprojnë sipas rregullave standarde të biznesit të tyre.

7. Fakti që një firmë e cila është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një firmë e cila është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, ose që zhvillon biznesin në atë shtet tjetër (qoftë nëpërmjet vendqëndrimit të përhershëm apo ndryshe), nuk përbën çdo firmë në vetvete vendqëndrim të përhershëm të firmës tjetër.

Neni 6

Të ardhurat nga pronat e paluajtshme

1. Të ardhurat që rrjedhin nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuritë e paluajtshme (duke përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pyjet) të ndodhura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues në të cilin ndodhet prona në fjalë. Në çdo rast, termi do të përfshijë pronën në vartësi të pasurisë së paluajtshme, gjësë së gjallë dhe pajisjeve të përdorura në bujqësi dhe pylltari, të drejtat për të cilat zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm në lidhje me tokën në

pronësi, të drejtën e përdorimit të pronës së paluajtshme dhe të drejtat për pagesa variabël ose fikse, si shpërblim për punën ose të drejtën për të punuar, depozitat minerare, burimet dhe pasuritë e tjera natyrore; anijet dhe avionët nuk do të konsiderohen si pasuri e paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, dhënia me qira ose përdorimi në çdo forme tjetër të pronës së paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 zbatohen gjithashtu për të ardhurat nga prona e paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme të përdorura për realizimin e shërbimeve personale të pavarura.

Neni 7

Fitimet e biznesit

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet, për sa kohë që ndërmarrja zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një vendqëndrimi të përhershëm të vendosur në të. Nëse ndërmarrja zhvillon biznesin siç është përmendur më sipër, fitimet e ndërmarrjes mund të tatohen në shtetin tjetër, por vetëm për ato që i atribuohen atij vendqëndrimi të përhershëm.

2. Në bazë të dispozitave të paragrafit 3, kur një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një vendqëndrimi të përhershëm të vendosur në të, në çdo Shtet Kontraktues atij vendqëndrimi të përhershëm do t'i atribuohen përfitimet të cilat mund të pritet të nxjerrë nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e ndarë, e përfshirë në aktivitete të njëjta ose të ngjashme, sipas kushteve të njëjta ose të ngjashme dhe që trajtojnë tërësisht në mënyrë të pavarur ndërmarrjen në të cilën ndodhet vendqëndrimi i përhershëm.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një vendqëndrimi të përhershëm, do të lejohen si zbritje shpenzimet që janë bërë për qëllime të vendqëndrimit të përhershëm, duke përfshirë shpenzimet ekzekutive dhe të përgjithshme administrative të bëra qoftë në shtetin në të cilin ndodhet vendqëndrimi i përhershëm ose diku tjetër.

4. Për sa kohë që është bërë e zakonshme në një Shtet Kontraktues të përcaktojë fitimet që do t'i atribuohen një vendqëndrimi të përhershëm mbi bazën e një ndarjeje të përfitimeve totale të ndërmarrjes ndaj pjesëve të saj të ndryshme, asgjë në paragrafin 2 nuk do ta përjashtojë atë Shtet Kontraktues nga përcaktimi i fitimeve që do të tatohen nga kjo ndarje, siç mund të jetë bërë e zakonshme; megjithatë metoda e ndarjeve të miratuara do të jetë e tillë që rezultati të jetë në pajtim me parimet në përmbajtje të këtij neni.

5. Asnjë përfitim nuk do t'i atribuohet vendqëndrimit të përhershëm për shkak vetëm të blerjes nga ai vendqëndrim i përhershëm të mallrave për ndërmarrjen.

6. Për qëllime të paragrafëve të mësipërm, përfitimet që do t'i atribuohen vendqëndrimit të përhershëm, do të përcaktohen me anë të së njëjtës metodë vit pas viti, për sa kohë që nuk ka arsye të fortë dhe të mjaftueshme për të kundërtën.

7. Kur fitimet përfshijnë zërat e të ardhurave që trajtohen veçmas në nenet e tjera të Marrëveshjes, dispozitat e atyre neneve nuk do të cenohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8

Transporti ndërkombëtar

1. Fitimet nga funksionimi i anijeve dhe avionëve në trafikun ndërkombëtar do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

2. Fitimet nga funksionimi i barkave të përfshira në transportin në ujërat e brendshme të lundrueshme do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

3. Nëse vendi i menaxhimit efektiv të një ndërmarrjeje transporti ose të një ndërmarrjeje

të transportit në ujërat e brendshme të lundrueshme është në bordin e një anijeje ose barkë, atëherë do të konsiderohet të jetë në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet porti i destinacionit të anijes ose barkës ose nëse nuk ka port destinacioni, në Shtetin Kontraktues në të cilin operatori i anijes ose barkës është rezident.

4. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen gjithashtu për përfitimet nga pjesëmarrja në një ortakëri, biznes të përbashkët ose agjenci operuese ndërkombëtare.

Neni 9
Ndërmarrjet e asociuara

1. Në rastet kur

a) një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe në secilin rast, kushtet që janë pranuar ose diktuar midis dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare apo financiare, ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që do të realizohej nga njëra ndërmarrje, por për shkak të lidhjeve të veçanta të përmendura në fillim nuk është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe për rrjedhojë të tatohet.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij shteti dhe taksat respektive, fitimet të cilat një ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues detyrohet të tatojë në shtetin tjetër dhe fitimet e përfshira janë fitimet, të cilat do t'i ishin shtuar ndërmarrjes së shtetit të përmendur më parë, nëse kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve kishin qenë ato që do të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë shteti tjetër do të bëjë një rregullim të përshtatshëm ndaj sasisë së taksave të vendosura mbi ato fitime. Në përcaktimin e këtij rregullimi, duhet t'i kushtohet vëmendje dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, nëse është e nevojshme, do të konsultohen me njëri-tjetrin.

Neni 10
Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një firmë që është rezidente e një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të tatohen gjithashtu në Shtetin Kontraktues në të cilin është rezidende firma që paguan dividendët dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur nuk do të tejkalojë:

a) 5 për qind të sasisë bruto të dividendëve, nëse pronari përfitues është një firmë (e ndryshme nga një ortakëri) që zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë të paktën 25 për qind të kapitalit të firmës që paguan dividendët;

b) 10 për qind të sasisë bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

Ky paragraf nuk do të cenojë tatimin e firmës në lidhje me fitimet nga të cilat janë paguar dividendët.

3. Termi "dividendë" siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji ose të drejta të tjera që nuk janë detyrime borxhi, që marrin pjesë në fitime, si dhe të ardhura

nga të drejta të tjera të korporatës, të cilat i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e shtetit në të cilin firma që bën shpërndarjen është rezidente.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i dividentëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin firma që paguan dividendët është rezidente, nëpërmjet një vendqëndrimi të përhershëm të vendosur në të ose kryen në atë shtet shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe që aksioni në lidhje me të cilin janë paguar dividendët është efektivisht i lidhur me vendqëndrimin e përhershëm ose bazën fikse. Në këtë rast, do të zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose 14.

5. Kur një firmë e cila është rezidente e një Shteti Kontraktues, nxjerr fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ai shtet tjetër mund të mos vendosë ndonjë tatim mbi dividendët e paguar nga firma, përveç rasteve kur këta dividendë i paguhen një rezidenti të atij shteti tjetër ose për sa kohë që aksioni në lidhje me të cilin janë paguar dividendët, është efektivisht i lidhur me vendqëndrimin e përhershëm ose një bazë fikse të vendosur në atë shtet tjetër dhe as nuk do t'ia nënshtrojë fitimet e pashpërndara të firmës një takse mbi fitimet e pashpërndara të firmës, edhe nëse dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara përbëhen tërësisht ose pjesërisht prej fitimeve ose të ardhurave të nxjerra në atë shtet tjetër.

Neni 11
Interesi

1. Interesi që lind në një Shtet Kontraktues dhe i paguar ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, ky interes mund të jetë i tatueshëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ai lind dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i interesit është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur nuk do të tejkalojë 5 për qind të shumës bruto të interesit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesi i përmendur në paragrafin 1 do të jetë i tatueshëm vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin marrësi është rezident, nëse pronari përfitues i interesit është rezident i atij shteti dhe:

a) është ai shtet, autoriteti lokal ose organi statutor i tij,

b) nëse interesi paguhet nga shteti në të cilin lind interesi ose nga një autoritet lokal apo organ statutor i tij,

c) nëse interesi paguhet në lidhje me një hua, detyrim borxhi ose kredie që i detyrohet, bëhet, jepet, garantohet ose sigurohet nga ai shtet ose autoritet lokal ose agjenci e tij financimi eksporti.

4. Termi "interes" siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga detyrimet e borxhit të çdo lloji, i siguruar apo jo me hipotekë dhe nëse ka apo jo të drejtë për të marrë pjesë në përfitimet e debitorit dhe në veçanti, të ardhurat nga letrat me vlerë qeveritare dhe të ardhurat nga obligacionet ose dëftesat e borxhit. Për qëllim të këtij neni, tarifat e gjobës për vonesë pagese nuk do të konsiderohen si interesa.

6. Dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i interesit, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin lind interesi, nëpërmjet një vendqëndrimi të përhershëm të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe detyrimi i borxhit në lidhje me të cilin është paguar interesi, është efektivisht i lidhur me këtë vendqëndrim të përhershëm ose bazë fikse. Në këtë rast, do të zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose 14.

7. Interesi do të konsiderohet të lindë në një Shtet Kontraktues kur paguesi është rezident i atij shteti. Megjithatë, kur një person që paguan interesin, qoftë rezident i Shtetit Kontraktues apo jo, ka në një Shtet Kontraktues vendqëndrim të përhershëm ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka ndodhur borxhi mbi të cilën është paguar interesi dhe ky interes përballohet nga ky vendqëndrim i përhershëm ose bazë fikse, atëherë interesi do të konsiderohet të lindë në shtetin

në të cilin ndodhet vendqëndrimi i përhershëm ose baza fikse.

8. Kur për shkak të një marrëdhënie të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e interesit, duke marrë parasysh detyrimin e borxhit për të cilin është paguar, tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënie, do të zbatohen dispozitat e këtij neni vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit Shtet Kontraktues, duke i kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Tarifat për të drejtat e autorit

1. Tarifat për të drejtat e autorit që lindin në një Shtet Kontraktues dhe të paguara ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto tarifa për të drejtat e autorit mund të tatohen gjithashtu në Shtetin Kontraktues në të cilin ato lindin dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i tarifave për të drejtat e autorit, është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur nuk do të tejkalojë 5 për qind të shumës bruto të tarifave për të drejtat e autorit.

3. Termi “tarifat për të drejtat e autorit” siç përdoret në këtë nen, nënkupton pagesat e çdo lloji të marra në lidhje me përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejte autori të veprës letrare, artistike ose shkencore, duke përfshirë filma kinematografikë dhe filmat ose kasetat për transmetim radiofonik ose televiziv, çdo patentë, markë tregtare, projektim ose model, plan, formulë sekrete ose proces ose për përdorimin ose të drejtën për të përdorur pajisje industriale, tregtare ose shkencore, ose për informacion në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i tarifave për të drejtat e autorit, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin lindin tarifat për të drejtat e autorit, nëpërmjet një vendqëndrimi të përhershëm të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe e drejta ose pronësia në lidhje me të cilat janë paguar tarifat për të drejtat e autorit, është e lidhur efektivisht me këtë vendqëndrim të përhershëm ose bazë fikse. Në këtë rast, do të zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

5. Tarifat për të drejtat e autorit do të konsiderohen të lindin në një Shtet Kontraktues, kur paguesi është rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan tarifat për të drejtat e autorit, qoftë rezident i Shtetit Kontraktues apo jo, ka në një Shtet Kontraktues vendqëndrim të përhershëm ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka ndodhur detyrimi për të paguar tarifat për të drejtat e autorit dhe këto tarifa përballohen nga ky vendqëndrim i përhershëm ose vend fiks, atëherë këto tarifa do të konsiderohen të lindin në Shtetin Kontraktues në të cilin është vendosur vendqëndrimi i përhershëm ose vendi fiks.

6. Kur për shkak të një marrëdhënie të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e tarifave për të drejtat e autorit, duke marrë në konsideratë përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin ato janë paguar, tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, do të zbatohen dispozitat e këtij neni vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit Shtet Kontraktues, duke i kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

Fitimet e kapitalit

1. Fitimet e nxjerra nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurisë së

paluajtshme të referuar në nenin 6 dhe të ndodhur në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme që përbëjnë pjesë të pronës së biznesit të një vendqëndrimi fiks që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose të pasurisë së luajtshme që i përket një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për qëllim të kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, duke përfshirë këto përfitime nga tjetërsimi i këtij vendqëndrimi të përhershëm (vetëm ose me të gjithë ndërmarrjen) ose të kësaj baze fikse, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

3. Fitimet nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që operojnë në trafikun ndërkombëtar, barkave të përfshira në transportin në ujërat e brendshme të lundrueshme ose prona e luajtshme që i përket funksionimit të këtyre anijeve, avionëve ose barkave do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Fitimet nga tjetërsimi i çdo prone të ndryshme nga ajo e referuar në paragrafët pararendës të këtij neni do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin tjetërsuesi është rezident.

Neni 14

Shërbimet personale të pavarura

1. Të ardhurat që rrjedhin nga një individ i cili është rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me shërbimet profesionale ose shërbime të tjera të ngjashme të një karakteri të pavarur, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet, përveç rrethanave të mëposhtme kur këto të ardhura mund të tatohen edhe në Shtetin tjetër Kontraktues:

a) nëse ai ka një bazë fikse që i vihet atij rregullisht në dispozicion në Shtetin tjetër Kontraktues për qëllim të kryerjes së aktiviteteve të tij; në atë rast vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet asaj baze fikse mund të tatohet në atë shtet tjetër; ose

b) nëse qëndrimi i tij në Shtetin tjetër Kontraktues është për një periudhë ose periudha që përmbledhin ose tejkalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës; në atë rast, vetëm ajo sasi të ardhurash që rrjedh nga aktivitetet e tij të kryera në atë shtet tjetër, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin veçanërisht aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore ose didaktike, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, dentistëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, audituesve dhe kontabilistëve.

Neni 15

Shërbimet personale të varura

1. Në bazë të dispozitave të nenit 16, 18 dhe 19, rrogat, pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme që rrjedhin nga një rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me një punësim, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet, nëse punësimi nuk ushtrohet në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet në këtë mënyrë, ky shpërblim që rrjedh mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimi i nxjerrë nga një rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me një punësim të ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues, do të jetë i tatueshëm vetëm në shtetin e përmendur më parë, nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) marrësi është i pranishëm në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i tejkalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore, e cila fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës, dhe

b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi, i cili nuk është rezident i shtetit tjetër, dhe;

c) shpërblimi nuk përballohet nga një vendqëndrim i përhershëm ose bazë fikse, të cilën punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht dispozitave pararendëse të këtij neni, shpërblimi i nxjerrë në lidhje me një punësim të ushtruar në bordin e një anijeje, avioni ose automjeti rrugor që operon në trafikun ndërkombëtar ose në bord një barkë e përfshirë në transportin në ujërat e brendshme të lundrueshme, mund të tatohet në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

Neni 16
Tarifat e drejtuesve

Tarifat e drejtuesve dhe pagesa të tjera të ngjashme që rrjedhin nga një rezident i një Shteti Kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtuesve ose një organi të ngjashëm të një firme e cila është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

Neni 17
Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, të ardhurat që rrjedhin nga një rezident i një Shteti Kontraktues në rolin e subjektit argëtues, si teatër, film, artist radioje ose televizioni ose muzikant apo sportist, nga aktivitetet e tij personale të ushtruara në këtë mënyrë në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat, në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një subjekt argëtues ose sportist në cilësinë e tij si i tillë, nuk i shtohen subjektit argëtues ose sportistit, por personit tjetër, ato të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e nenene 7, 14 dhe 15, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e subjektit argëtues apo sportistit.

Neni 18
Pensionet

1. Në bazë të dispozitave të paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe pagesa të ngjashme të paguara ndaj një rezidenti të një Shteti Kontraktues duke marrë parasysh punësimin e shkuar, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, pensionet dhe shpërblimet e tjera të bëra sipas legjislacionit të sigurimeve shoqërore të një Shteti Kontraktues, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, pensionet dhe pagesat e tjera të ngjashme (duke përfshirë pagesat e shumave të përgjithshme) që lindin në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, do të jenë të tatueshme vetëm në shtetin e përmendur më parë, me kusht që këto pagesa të rrjedhin nga kontributet e paguara për/ose nga rregullimet e bëra sipas një skeme pensioni nga marrësi ose në emër të tij dhe që këto kontribute, rregullime ose pensione apo shpërblime të tjera të ngjashme i nënshtrohen tatimit në shtetin e përmendur më parë sipas rregullave të zakonshme të ligjeve të tij tatimore.

Neni 19
Shërbimi qeveritar

1.a) Rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, të paguara nga një Shtet Kontraktues ose një autoritet lokal i tij për një individ, në lidhje me shërbimet e kryera për atë shtet ose autoritet, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto rroga, paga dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse shërbimet kryhen në atë shtet dhe nëse individi është rezident i atij shteti që

i) është shtetas i atij shteti ose

ii) nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2.a) Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të paguara nga/ose prej fondeve të krijuara nga një Shtet Kontraktues ose autoritet lokal i tij për një individ mbi shërbimet e kryera në atë shtet ose autoritet, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto pensione dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse individi është rezident dhe shtetas i atij shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16, 17 dhe 18 do të zbatohen për rrogat, pagat, pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme në lidhje me shërbimet e kryera mbi një biznes të zhvilluar nga një Shtet Kontraktues ose autoritet lokal i tij.

Neni 20

Studentët dhe stazhierët

1. Pagesat që merren nga një student ose stazhier biznesi, i cili është ose ka qenë menjëherë para vizitës së Shtetit Kontraktues, rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që është i pranishëm në shtetin e përmendur më parë vetëm për qëllime të edukimit ose trajnimit të tij, për qëllime të mirëmbjtjes, edukimit ose trajnimit të tij, nuk do të tatohen në atë shtet, me kusht që këto pagesa të lindin nga burime jashtë atij shteti.

2. Në lidhje me grantet, bursat dhe shpërblimet nga punësimi, të pambuluara nga paragrafi 1, një student ose stazhier biznesi i përshkruar në paragrafin 1, për më tepër do të jetë i autorizuar gjatë kësaj periudhe edukimi ose trajnimi mbi të njëjtat përjashtime, lehtësira ose ulje për tatimet në dispozicion të rezidentëve të shtetit të cilin po viziton.

Neni 21

Të ardhura të tjera

1. Zërat e të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kudo që lindin, të patrajtuara në nenet pararendëse të kësaj Marrëveshjeje, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen për të ardhurat e ndryshme nga të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, nëse marrësi i këtyre të ardhurave duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një vendqëndrimi të përhershëm të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe e drejta ose prona në lidhje me të cilat janë paguar të ardhurat është efektivisht e lidhur me atë vendqëndrim të përhershëm ose bazë fikse. Në këtë rast, do të zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

Neni 22

Kapitali

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuria e paluajtshme referuar në nenin 6, i zotëruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe i vendosur në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuria e luajtshme që përbën pjesë të pronës së biznesit të një vendqëndrimi të përhershëm, të cilin një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga pasuria e luajtshme që i përket një baze fikse në dispozicion të një

rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues, për qëllim të kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anijet dhe avionët që operojnë në trafikun ndërkombëtar dhe nga barkat e përfshira në transportin në ujërat e brendshme të lundrueshme, si edhe nga prona e luajtshme që i përket funsionimit të këtyre anijeve, avionëve dhe barkave, do të jetë i tatueshëm vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

Neni 23
Eliminimi i tatimit të dyfishtë

1. Në rastin e Luksemburgut:

Në bazë të dispozitave të ligjit të Luksemburgut në lidhje me eliminimin e tatimit të dyfishtë që nuk do të cenojë parimin e përgjithshëm të tij, tatimi i dyfishtë do të eliminohet si më poshtë:

a) Kur një rezident i Luksemburgut nxjerr të ardhura ose zotëron kapital që në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të tatohen në Shqipëri, Luksemburgu, në bazë të dispozitave të nënparagrafëve (b) dhe (c), do t'i përjashtojë këto të ardhura ose kapital nga tatimet, por me qëllim llogaritjen e vlerës së tatimeve mbi të ardhurat ose kapitalin e mbetur të rezidentit, mund të aplikojë të njëjtat përqindje tatimesh sikur të ardhurat ose kapitali të mos ishin përjashtuar.

b) Kur një rezident i Luksemburgut nxjerr të ardhura që në pajtim me dispozitat e neneve 10, 11, 12 dhe 17 mund të tatohen në Shqipëri, Luksemburgu do të lejojë si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat mbi individët ose nga tatimi e korporatës së atij rezidenti një shumë të barabartë me taksën e paguar në Shqipëri. Megjithatë, kjo zbritje nuk do të tejkalojë atë pjesë të taksës që llogaritet para se të jepet zbritja, e cila i atribuohet atyre zërave të të ardhurave të rrjedhura nga Shqipëria.

c) Dispozitat e nënparagafit (a) nuk do të zbatohen për të ardhurat që rrjedhin ose kapitalin e zotëruar nga një rezident i Luksemburgut, kur Shqipëria zbaton dispozitat e kësaj Marrëveshjeje për t'i përjashtuar këto të ardhura ose kapital nga tatimet ose zbaton dispozitat e paragrafit 2 të neneve 10,11 ose 12 për këto të ardhura.

2. Në rastin e Shqipërisë:

a) Kur një rezident i Shqipërisë nxjerr të ardhura ose zotëron kapital, që në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të tatohen në Luksemburg, Shqipëria do të lejojë:

i) si zbritje nga tatimi shqiptar mbi të ardhurat e atij rezidenti një shumë të barabartë me taksën mbi të ardhurat të paguar në Luksemburg, dhe

ii) si zbritje nga tatimi shqiptar mbi kapitalin e atij rezidenti, një shumë të barabartë me kapitalin e paguar në Luksemburg.

Megjithatë, kjo zbritje në asnjë rast nuk do ta tejkalojë atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat ose kapitalin që llogaritet para se të jepet zbritja, e cila i atribuohet, sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit që mund të tatohen në Luksemburg.

b) Kur në pajtim me ndonjë dispozitë të kësaj Marrëveshjeje, të ardhurat e rrjedhura ose kapitali nga një rezident i Shqipërisë përjashtohen nga tatimet në Shqipëri, megjithatë, në llogaritjen e vlerës së tatimeve mbi të ardhurat ose kapitalin e mbetur të këtij rezidenti, Shqipëria mund të marrë parasysh të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

Neni 24
Mosdiskriminimi

1. Shtetasit e një Shteti Kontraktues nuk do t'i nënshtrohen tatimit të Shtetit tjetër Kontraktues ose çdo kërkese në lidhje me të që ndryshon ose është më e rreptë sesa tatimi dhe kërkesat përkatëse ndaj të cilave shtetasit e atij shteti tjetër mund t'i nënshtrohen në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me rezidencën. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, kjo dispozitë do të zbatohet edhe ndaj personave të cilët nuk janë rezidentë të një ose dy Shteteve Kontraktuese.

2. Tatimi mbi një vendqëndrim të përhershëm që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues, nuk do të vendoset në mënyrë më pak të favorshme në atë shtet tjetër sesa tatimi i vendosur mbi ndërmarrjet e atij shteti tjetër që zhvillon të njëjtat aktivitete. Kjo dispozitë nuk do të interpretohet si detyruese për një shtet Kontraktues për t'u dhënë rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues çdo zbritje financiare personale, lehtësira dhe ulje për qëllime tatimore, duke marrë parasysh statusin civil ose përgjegjësitë familjare, të cilat u jepen vetëm rezidentëve të vet.

3. Përveç rasteve kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, të paragrafit 7 të nenit 11 ose të paragrafit 6 të nenit 12, interesi, tarifat për të drejtat e autorit dhe disbursime të tjera të paguara nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për qëllim të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të zbritshme sipas të njëjtave kushte sikur t'i ishin paguar një rezidenti të shtetit të përmendur më parë. Në mënyrë të ngjashme, çdo borxh i një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për qëllim të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj ndërmarrjeje, do të jetë i zbritshëm sipas të njëjtave kushte sikur t'i ishin kontraktuar rezidentit të shtetit të përmendur më parë.

4. Ndërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave zotërohet tërësisht ose pjesërisht ose kontrollohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do t'i nënshtrohet asnjë tatimi në shtetin e përmendur më parë ose çdo kërkese në lidhje me të, që është e ndryshme ose më e rreptë sesa tatimi dhe kërkesat e ngjashme të cilave mund t'i nënshtrohen ndërmarrje të tjera të ngjashme të shtetit të përmendur më parë.

5. Dispozitat e këtij neni do të zbatohen për tatimet e mbuluara nga kjo Marrëveshje.

Neni 25

Procedura e Marrëveshjes së ndërsjellë

1. Kur një person konsideron se veprimet e një ose të dy Shteteve Kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për të, gjatë taksimit, në mospajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga mjetet e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, mund t'ua paraqesë çështjen e tij autoritetit kompetent të Shtetit Kontraktues në të cilin është rezident ose nëse çështja e tij trajtohet në paragrafin 1 të nenit 24, mund t'u paraqesë autoriteteve kompetente të Shtetit Kontraktues në të cilin është shtetas. Çështja mund të paraqitet brenda tre vjetësh nga njoftimi i parë i veprimit, që rezulton nga taksimi në mospajtim me dispozitat e Marrëveshjes.

2. Nëse kundërshtimi duket të jetë i justifikuar dhe nëse nuk është në gjendje të arrijë në zgjidhje të kënaqshme, autoriteti kompetent do të përpiqet ta zgjidhë çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangien e tatimit që nuk është në pajtim me Marrëveshjen. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht ndonjë afati kohor në legjislacionin e brendshëm të Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen të zgjidhin me anë të marrëveshjes së ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshim që lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Marrëveshjes. Ata gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet të cilat nuk janë parashikuar në Marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin

në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke përfshirë një komision të përbashkët që përbëhet prej vetë atyre ose përfaqësuesve të tyre, për qëllim të arritjes së një marrëveshjeje në kuptimin e paragrafëve pararendës.

Neni 26
Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktues do të shkëmbejnë informacionin e nevojshëm për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose të ligjeve të brendshme të Shteteve Kontraktuese në lidhje me tatimet e mbuluara nga Marrëveshja në atë masë që tatimi më poshtë të mos jetë në kundërshtim me Marrëveshjen.

Çdo informacion i marrë nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si konfidencial në të njëjtën mënyrë informacioni i përftuar sipas ligjeve të brendshme të atij shteti dhe do të jepet vetëm për personat ose autoritetet (duke përfshirë gjykata dhe organe administrative) që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin ose procedimin në lidhje me/ose përcaktimin e apeleve rreth tatimeve të mbuluara nga Marrëveshja. Këta persona ose autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund të japin informacionin në procedime seancash gjyqësore me dyer të hapura ose në vendime gjyqësore.

2. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 1 nuk do të interpretohen si të tilla që të vendosin mbi një Shtet Kontraktues detyrimin:

a) për të realizuar masa administrative në mospajtim me ligjet dhe praktikën administrative të atij Shteti Kontraktues ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) të japin informacion që nuk është i përftueshëm sipas ligjeve ose në punën normale të administratës së atij Shteti Kontraktues apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) të japin informacion që do të zbulonte çdo sekret tregtar, biznesi, industrial, tregtar ose profesional ose proces tregtie apo informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

Neni 27
Anëtarët e misioneve diplomatike dhe postave konsullore

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të cenojë privilegjet fiskale të anëtarëve të misioneve diplomatike ose postave konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 28
Hyrja në fuqi

1. Shtetet Kontraktues do të njoftojnë njëri-tjetrin me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike se janë përmbushur procedurat e kërkuara nga ligji i tyre për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshja do të hyjë në fuqi datën e marrjes së njoftimit të fundit.

2. Marrëveshja do të zbatohet:

a) Në lidhje me tatimet e mbajtura në burim, për të ardhurat që rrjedhin në datën ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik të ardhshëm pas vitit në të cilin Marrëveshja hyn në fuqi;

b) Në lidhje me tatimet e tjera mbi të ardhurat dhe tatimet mbi kapitalin, për tatimet e kërkuara për çdo vit të tatueshëm në datën ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik të ardhshëm pas vitit në të cilin Marrëveshja hyn në fuqi.

Për qëllime të nenit 26 (Shkëmbimi i informacionit), dispozitat do të kenë fuqi në datën ose pas datës në të cilën Marrëveshja hyn në fuqi.

Neni 29
Përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi derisa të përfundohet nga një Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund t'i japë fund Marrëveshjes nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke dhënë një njoftim në lidhje me përfundimin të paktën gjashtë muaj para fundit të çdo viti kalendarik që fillon pas skadimit të një periudhe prej pesë vjetësh nga data e hyrjes së saj në fuqi.

2. Marrëveshja do të pushojë së paturi efekt:

a) në rast të tatimeve të mbajtura në burim, në lidhje me të ardhurat që rrjedhin në datën ose pas datës 1 janar në vitin kalendarik të ardhshëm, pas vitit në të cilin është dhënë njoftimi;

b) në lidhje me tatimet e tjera mbi të ardhurat dhe tatimet mbi kapitalin, në lidhje me tatimet e kërkuara për çdo vit të tatueshëm që fillon në datën ose pas datës 1 janar në vitin kalendarik të ardhshëm pas vitit në të cilin është dhënë njoftimi.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar sipas rregullit, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje në Tiranë, më 14 janar 2009, në gjuhën shqipe dhe frënge, të dyja tekstet njëlloj autentike.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë Lulzim Basha Ministër i Punëve të Jashtme	Për Qeverinë e Dukatit të Madh të Luksemburgut Jean Asselborn Ministër i Punëve të Jashtme